



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

**PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR PROVIMIN E SHTETIT NË PROFESIONET E RREGULLUARA NË FUSHËN E
MJEKËSISË SEZONI XXVIII**

Për të gjithë kandidatët aplikantë për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Mjekut, Farmacistit, Stomatologut, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Logopedistit, Teknikut të Imazherisë dhe Teknikut të Laboratorit, ju informojmë se aplikimi do të kryhet online përgjatë periudhës **20 – 25 Janar 2026**, duke përdorur shërbimin “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania. Provimi do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë, ish-ATSH), sipas kalendarit i cili do të publikohet në vijim.

Gjatë aplikimit online, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

1. Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin respektiv;

** Vetëm në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit; Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur. Dokumenti që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara.*

2. Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga UP-ja ose në mungesë të UP-së, nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;

3. Vetëm pas njoftimit të pranimit nga Urdhri Profesional, faturën e pagesës (në formatin PDF me emërtesën “pagesa”) së kryer për llogari të QSHA-së, e cila duhet të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë, brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit nga Urdhri Profesional. Formulari për kryerjen e pagesës: <https://qsha.gov.al/fatura-per-arketim/>

Kandidati do të njoftohet në çdo fazë të aplikimit nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia. Gjithashtu, me anë të kodit unik të gjurmimit mund të gjurmojë në çdo kohë statusin e aplikimit. Pas ngarkimit në sistem të pagesës, lutemi që kandidati të qëndrojnë në pritje të email-it të pranimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

- Kandidati ditën e provimit duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me dokument identifikimi (Kartë identiteti ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
- Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:
 - ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
 - ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
 - ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
 - ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Për çdo pasaktësi lidhur me të dhënat në listat që do të publikohen në faqen zyrtare të QSHA www.qsha.gov.al, lutemi që kandidati t'i drejtohet Urdhrit Profesional përkatës.

Për informacion më të detajuar lidhur me aplikimin, si dhe procedurat e provimit të shtetit, lutemi të ndiqni linkun: <https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/Informacion-Lidhur-me-Provimin-e-Shtetit-ne-Profesionet-e-Rregulluara.pdf>

Ju urojmë Suksese!